



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë- Ministarstvo za Obrazovanje, Nauke i  
Tehnologija--Ministry of Education Science and Technology

Zyra e Sekretarit të përgjithshëm/Kancelarija Generalnog Sekretara/Office of the General  
Secretary

Nr. 2-1203  
Datë 05.06.2018

Sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në mbështetje të nenit 38 të Ligjit nr. 03/L/189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës, (Gazeta zyrtare nr. 82, 21 tetor 2010), nenit 2, paragrafi 1, nënparagrafi 1.12. nënparagrafet. 1.12.3, 1.12.4, 1.12.5 të UA- nr. 03/2018 dt. 28.01.2018, nenit 17 dhe shtojcës 6 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, të dt. 22.03.2011, nxjerr:

#### V E N D I M

#### Për lejimin e ndryshimit të emërtimeve të profileve

1. Lejohet ndryshimi i emërtimeve të profileve në fushën e shëndetësisë, si më poshtë:
  - 1.1. Nga “Asistent infermier i përgjithshëm” në “Infermier i përgjithshëm”;
  - 1.2. Nga “Asistent infermier i mamisë” në “Mami”;
  - 1.3. Nga “Ndihmës infermier i përgjithshëm” në “Infermier i përgjithshëm”;
  - 1.4. Nga “Ndihmës infermier i pediatriisë” në “Infermier i pediatriisë”.
2. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

#### A r s y e t i m

Duke u mbështetur në dispozitat e shënuara më lartë dhe në bazë të kërkesës nr. 3/1203 të dt. 30.05.2018 së DPAP për lejimin e ndryshimit të emërtimeve të profileve të arsimit dhe aftësisimit profesional të fushës së shëndetësisë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### Vendimi u dërgohet:

1. Odës së infermierëve të Kosovës;
2. DPAP/MASHT;
3. Zyrës së SP/MASHT;
4. Arkivit.

